

## Ne jemi këtu për ju!

### Skudra terapeutike



#### Martina Mura

Social-Pedagoge e Diplomuar  
Shëruese për psikoterapi  
Terapi organizative dhe traumatike



#### Denise Busch

B.a.ch.-Psikolog,  
shoqërim Psikologjik  
dhe këshillim



#### Hamza Kabori

B.a.ch.-Psikolog,  
shoqërim Psikologjik  
dhe këshillim

### Skudra social-pedagogjike



#### Sabine Böhmer-Merz

Infermiere,  
Shoqërim social-pedagogjik dhe  
këshillim,  
Biseda sqaruese



#### Wolfgang Stücher

ndërmjetës gjuhësor dhe integruar,  
Shoqërim social-pedagogjik dhe  
këshillim,  
Biseda sqaruese

**PSZ Siegen**  
Psychosoziales Zentrum für Flüchtlinge



Kreisverband  
Siegen-Wittgenstein / Olpe



### Takimet kryhen pasi është rënë dakord më parë

Qendra psiko-sociale Siegen  
Sandstraße 28 / 4. Kati i dytë  
57072 Siegen  
Telefon 0271 250115 12  
Fax 0271 250115 13  
E-Mail [info@psz-siegen.de](mailto:info@psz-siegen.de)  
Internet [www.psz-siegen.de](http://www.psz-siegen.de)

Mbështetet nga

Ministerium für Kinder, Familie,  
Flüchtlinge und Integration  
des Landes Nordrhein-Westfalen



Fotografi: © Roman Bodnarchuk - Fotolia.com; © marjana4782 - Fotolia.com

## Qendra psiko-sociale Siegen

**Këshillim dhe mundësi terapeutike për refugjatë të traumatizuar dhe Të ndikuar psikikisht**

Një bashkëpunim i:



Kreisverband  
Siegen-Wittgenstein / Olpe



## Ndihmë profesionale për të arratisurit

Shoqata e qarkut AWO Siegen-Wittgenstein/Olpe dhe Klubi për Punë Sociale dhe Kulturë Südwestfalen e.V. qëndrojnë në angazhimin e tyre shoqëror për solidaritet, liri, tolerancë dhe drejtësi

Bazuar në këtë traditë të mirë PSZ Siegen punon me refugjatë dhe njerëz të arratisur të traumatizuar dhe që kanë pasur ndikime psikologjike, të cilët kanë qenë viktime të luftës, torturës, dhunës seksuale si dhe të poshtërimeve dhe keqtrajtimeve.

Ky institucion ndodhet në Siegen, disa minuta larg në këmbë nga stacioni i trenit dhe ka si zone mbulimi rajonin e Vestfalisë së Jugut.

Skuadra jonë multi-profesionale disponon kompetenca të punës sociale dhe të psiko-terapisë, për të mund të reagojë shpejt dhe me lehtësi si dhe me profesionalizëm kundrejt nevojës aktuale të lartë për trajtim, këshillim dhe përkujdesje kundrejt refugjatëve. Ne, me anën e këshillimeve të synuara dhe mundësive të përshtatshme terapeutike mund të fillojmë stabilizimin psiko-social dhe të ndërmarim hapat e parë për përbalimin e përjetimeve traumatike, të tregojmë rrugë të aspektit social dhe të kontribuojmë në këtë mënyrë për integrimin e emigrantëve.

Shërbimet tona për refugjatët dhe familjarët e tyre janë falas; sigurimi i statusit të qëndrimit për personat që kërkojnë të këshillohen nuk është e domosdoshme për punën tonë. Në rast nevoje, për këshillimin kemi në dispozicion përkthyes, përkthyes\* të trajnuar posaçërisht për këtë gjë.

Shërbimet tona jepen në kuadrin e një masë plotësuese në kuadrin e një trajtimi të specializuar mjekësor eventualisht të ndikuar me anën e një ekzaminimi të parë kompetent diagnostikues, masat e para stabilizuese terapeutike si dhe dërgimi i synuar për te specialistët dhe te sisteme të tjerë ndihmues.

## Ne ofrojmë

- **Zbulim** – diagnostikim kompetent ambulant për përcaktimin dhe vlerësimin e ngarkesës psikike
- **Ndërhyrje në rast krize** për stabilizimin emocional dhe ndihmën e parë psiko-terapeutike
- **Menaxhim i planit të ndihmës** me pjesëtarët e familjes, terapeutistët dhe kontribuuesit vullnetar në vend për sigurimin e integritit
- **Ekspertiza** në formën e opinionëve në procedurën e azilit
- **Ruajtja e marrëdhënieve** për një bashkëpunim optimal me Institucionet shëndetësore, klinikat, specialistët në afërsi dhe shërbimit social-psikiatrik në veçanti
- **Shërbime psiko-terapeutike** në seanca të veçanta dhe në grupe
- **Punë për projektin** për optimizimin e strukturave të përkujdesjes dhe sistemeve të kontribuuesve
- **Workshop-e dhe seminare** për trajnimin e kontribuuesve vullnetarë, nunëve, specialistëve dhe multiplikatorëve

AWO dhe VAKS disponojnë një përvojë disa-vjeçare në punën me refugjatët. Kompetencat profesionale të fituara në këtë mënyrë në çështjet e azilit dhe ato të së drejtës sociale si dhe profesionalizmi organizativ na ofron neve një bazë të qëndrueshme pune: si në pozicionin e këshilluesit për raste të veçanta ashtu edhe në mënyrë sistematike në formën e trajnimeve dhe mbikëqyrjeve të rregullta.



## E lehtë për tu gjetur në qendrën e qytetit të Siegen

### Qendra psiko-sociale Siegen

Sandstraße 28 / 4.OG  
57072 Siegen

